



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-051

Prishtinë, më 20 shkurt 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë K R Y E S I S Ë T Ë K U V E N D I T, T Ë M B A J T U R M Ë 2 0 S H K U R T 2 0 1 2

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 shkurt 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Kërkesa e Radio Televizionit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të auditimit të performancës së RTK-së.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 shkurt 2012

Kryesia miratoi procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 shkurt 2012.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti pati vërejtje në transkript, në faqen 11, e cila është korrigjuar.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Meqë komisionet parlamentare, gjatë kësaj jave ishin në përgatitje e sipër të raporteve për shqyrtimin e projektligjeve, Kryesia vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 1 mars 2012. Rendi i ditës për mbledhje plenare do të caktohet në mbledhjen tjetër të Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim-vendimin e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

2. Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë së Pronës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim-vendimin e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozim- vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë së Pronës dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Pika shtesë:

1. Kërkesa e Radio-Televizionit të Kosovës, për mbulimin e shpenzimeve të auditimit të performancës së RTK-së

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Radio-Televizionit të Kosovës, për mbulimin e shpenzimeve të auditimit të performancës së RTK-së dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale